




ODA E AVOKATËVE TË KOSOVËS
ADVOKATSKA KOMORA KOSOVA
KOSOVO BAR ASSOCIATION



V. KD. Nr.1205-4-1/2021

KOMISIONI DISIPLINOR I ODËS SË AVOKATËVE TË KOSOVËS, në kolegjin e përbërë nga Sarandë Beqiri - Kryetare, - Agron Curri - anëtar dhe Rrahim Ajeti - anëtar, me pjesëmarrjen e Vjollca Ajeti - Administratore në Zyrën Disiplinore të OAK - procesmbajtëse, duke vendosur lidhur me propozimin e Prokurorit Disiplinor me nr.1205-4/21 të datës 13.12.2022, ndaj të paraqiturit av. _____, me adresë në _____, sipas nenit 16 të Rregullores për Procedurën Disiplinore të OAK-së të datës 07.03.2020, pas zhvillimit të seancës së shqyrtimit kryesor më datën 07.02.2023, merr këtë:

V E N D I M

- I.** **APROVOHET** propozimi i Prokurorit Disiplinor me nr.1205-4/2022 të datës 13.12.2022, shpallët përgjegjës avokati _____ nga _____, për shkak se me datën 15.10.2021, përmes rrjetit të tij social 'facebook' ka shpërndarë video të tij së bashku me klient duke i premtuar publikisht se nëse i njëjti zgjidhet asamblistë në Kuvendin Komunal të Komunës së _____, nga kjo pozitë dhe duke ushtruar profesionin e avokatit do të zgjidhë çështjen e tij gjyqësore. Me këtë _____ ka bërë shkelje të rëndë disiplinore nga neni 118 par. 1.2 të Statutit të OAK -së, lidhur me nenin 7, 13 pika g, 75, të Kodit të Etikës Profesionale të Avokatit.
- II.** I Shqiptohet Masa Disiplinore gjobë në shumën prej 500 € (pesëqind euro).
- III.** Obligohet i paraqitur av. _____, që në emër të paushallit disiplinor të paguaj shumën prej 50.00 € (pesëdhjetë) euro.
- IV.** Pagesa e gjobës dhe paushallit duhet të bëhen në buxhetin e OAK-së, në afatin prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij vendimi, nën kërcënimin e përmbarimit të detyrueshëm.

A r s y e t i m

Kolegji Disiplinor i OAK-së, pas pranimit të propozimit nga Prokurori Disiplinor i OAK-së, me nr. 1205-4/2022 të datës 13.12.2022, ka caktuar dhe mbajtur shqyrtimin fillestar, në përbërje të plotë me datë 22.12.2022. Pas shqyrtimi paraprak të çështjes disiplinore dhe provave në shkresat e lëndës, komisionin, vlerësoi se janë plotësuar kushtet nga neni 16 i Rregullores për Procedurën

Disiplinore, ashtu që mori vendim për konfirmimin e propozimit të Zyrës së Prokurorit Disiplinor, dhe zhvillimit të procedurës disiplinore.

Komisioni ka caktuar shqyrtimin kryesor me datë 11.01.2023, ora 13:30, seancë e cila është shtyrë për shkak të kërkesës së të paraqiturit me arsyetimin e pjesëmarrjes në ceremoninë mortore të z. Hajrip Krasniqi (tani i ndjeri) që kishte ndërruar jetë ditë më parë. Bazuar në këtë arsyetim, komisioni jashtë seancës ka vendosur të shtyj atë, për datën 07.02.2023, ora 13:30 minuta.

Me datën 06.02.2023, ora 17:28, i paraqituri përmes e-mailit, ka kërkuar shtyrjen e seancës me arsyetimin se për shkak të gjendjes shëndetësore dhe temperaturës së ulët nuk do të mund të marr pjesë.

Në seancën e shqyrtimit kryesor, të datës 07.02.2023, komisioni, refuzoi kërkesën për shtyrje të seancës pasi të njëjtën e gjenit të pa arsyetuar, për faktin se i paraqituri nuk kishte bashkangjitur as një provë apo dëshmi kërkesës së parashtruar. Bazuar në neni 20 paragrafi 5 të Rregullores për Procedurën Disiplinore për Avokatëve dhe Praktikantë, komisioni vendosi që shqyrtimi kryesor të mbahet në mungesë të të paraqiturit.

Në kuptim të nenit 35 paragrafi 3, kolegji, ka bërë vlerësimin e gjitha provave veç e veç, ashtu që fillimisht shqyrtoi përmbajtjen e postimit nga i paraqituri në rrjetin social 'facebook' të datës 15.10.2021, me protokoll 47/21, leximi i CD, ku dëgjohet dhe shihet pamjet e të paraqiturit me klientit e tij; Njoftimi 1205-1/21 i datës 15.11.2021; dhe Përgjigjen e avokatit të paraqitur , e datës 16.12.2022.

Kolegji pasi vlerësoj postimin në 'facebook', së bashku me përshkrimin (tekstin e postimit) erdhi në përfundimin se; një deklarami i tillë është në kundërshtim me neni 10 i Kodit të Etikës Profesionale, i cili përcakton se avokati gjatë përfaqësimit është i obliguar të ruaj pavarësinë e tij të plotë, të liruar nga çdo trysni, posaçërisht nga ato që dalin nga interesat e tij vetiake ose nga ndikimet e jashtme.

Me veprimet e tij i paraqitur duke u thirrur në një post që do të merrte në asamblenë komunale, faktin se ai pikërisht duke shfrytëzuar ndikimin nga jashtë, konkretisht përfshirjen e tij në politikë dhe proceset vendimmarrëse, dhe duke qenë avokat i angazhuar në këtë rast do të zgjidhte çështjen e klientit të tij.

Një veprim i tillë bije ndesh me këtë dispozitë, pasi që avokati përfaqësimin e tij në çdo rast duhet ta bëjë vetëm duke u mbështetur në punën profesionale, duke respektuar normat ligjore dhe Kodin e Etikës Profesionale, dhe i pa ndikuar.

Qasja e tillë e avokatit të paraqitur në këtë rast përbën shkelje të neni 13 pika g, të Kodit të Etikës, i cili shprehimisht ka përcaktuar se çdo jo lojalitet në afarizëm është në kundërshtim me këtë kod, veçanërisht nëse ai thirret në lidhjet e tij të ngushta shoqërore ose partiake. Në këtë rast avokati shprehimisht ka theksuar se në postimin e tij se, citoj: "... kam shprese që e njëjta do të zgjidhet nga perfaqësimi im i angazhuar si avokat dhe po ashtu si kandidat, brenda asamblesë së Komunitetit të Prizrenit".

Me këtë komisioni vërtetoi se i paraqituri, duke qenë i angazhuar si avokat në një çështje kontestimore, ka premtuar se zgjidhjen e rastit do ta bëjë po ashtu duke shfrytëzuar edhe pozitën e tij partiake dhe angazhimit në kuvendin komunal.

Kjo formë e komunikimit e të paraqiturit në cilësinë e avokatit me klientin e tij, paraqet shkelje në mënyrë se si avokati duhet të realizoj konsultat dhe kontaktet me klientin. Nga CD e lexuar shihet se avokati është bashkë me klientin në një ambient të jashtëm siç duket në pronën për të cilën është duke u zhvilluar kontesti. Neni 75 i Kodit të Etikës Profesionale të Avokatit, përcakton se avokati konsultat me palët duhet të zhvilloj në zyrën e tij, ose vetëm përjashtimisht në vend tjera por të cilat nuk e dëmtojnë prestigjin dhe autoritetin e avokatit. Kjo formë e komunikimit e cila për më tepër edhe është shpërndarë, sigurisht ka cenuar prestigjin dhe autoritetin e avokatisë në opinionin e gjerë, pasi që një rasti gjyqësor dhe i njohur është përdorur për fushatë politike duke premtuar zgjidhjen e rastit në favor të palës, e të cilën kodi i etikës e ndalon shprehimisht.

Rrjetet sociale tani më paraqesin një komunikim publik të gjerë apo në masë, veçanërisht 'facebook'. I paraqituri në këtë rast në videon e shpërndarë, por edhe shkrimin të cilin e ka bërë në postimin e tij, përmbajtja e të cilit haptazi është një thirrje dhe reklamim i punës së tij si avokat, e duke u thirr edhe në angazhimin e tij politik ka shkelur pos tjerash edhe neni 79 paragrafi 4 pika c, të Kodit të Etikës për Avokatët, e cila dispozitë avokatit ja ndalon që të paraqitet publikisht me qëllim të imponimit të tij në opinionin publik.

Përmbajtja e postimit dhe deklarimit të tij në video, përbën shkelje pasi që i paraqituri haptazi promovon punën e tij si avokatë dhe kërkon që të përkrahet në procesin zgjedhor për asamblist në Komunitetin e Prizrenit, pasi që në këtë formë do të zgjidh edhe çështje konkrete në proceset gjyqësore. Në këtë mënyrë shihet edhe qëllimi i të paraqiturit që të promovoj punën e tij si avokat duke deklarua se ai çështjet ligjore do t'i zgjedh edhe duke shfrytëzuar lidhjet e tij politike apo partiake, e të cilat përbëjnë shkelje të kodi të etikës.

Kolegji Disiplinor, vlerësoi edhe përgjigjen e avokatit, të datës 16.12.2021, me të cilin i njëjti nuk ka mohuar apo arsyetuar pretendimet për shkeljet e paraqitura, mirëpo i është referuar rasteve të

kolegëve të tjerë duke pretenduar se angazhimi i tij në aktivitete politike dhe përmbajtja e deklaramit të tij nuk përbën shkelje disiplinore. Si dhe faktin se ai nuk ka arritur të zgjedhet në procesin zgjedhor. Këtë përgjigje kolegji e gjeti të pa mbështetshme dhe të pa bazuar, kurse lidhur me atë se i njëjti nuk është zgjedhur, është irelevante për këtë procedurë, pasi që objekt është trajtimi i deklaramit dhe mënyrës së komunikimit të avokatit në raport e kodin e etikës.

Për më tepër në këtë pikë, bazuar në nenin 4 të Kodit të Etikës të Avokati, është përcaktuar deçdivisht kur dhe në çfarë rrethanash mundet një avokat të angazhohet në marrëdhënie jo të rregullta të punës. Pra avokati mund të angazhohet në cilësinë e ekspertit, këshilltarit dhe të ngjashme si këto në trupa të caktuara profesionale, e të cilat nuk janë marrëdhënie të rregullta të punës dhe nuk bijnë në kundërshtim me profesionin e avokatit. Me këtë dispozitë është qartë se avokati mund të angazhohet vetëm në cilësinë e ekspertit apo këshilltarit, ndryshe angazhimi në çfarëdo cilësie tjetër, ai duhet ta bëjë pezullimin e licencës së avokatit.

Në këtë mënyrë kolegji pasi bëri vlerësimin e të gjitha provave veç e veç dhe të gjitha së bashku, erdhi në përfundimin se shpërndarja videos dhe përmbajtja e postimit, e avokatit të paraqitur në rrjetin e tij social 'facebook' përbën përgjegjësi disiplinore në kuptim të nenit 118 pika 1.3 të Statutit të OAK -së, lidhur me neni 7 paragrafi 2 neni 13 pika g, dhe neni 75 të KEPA-së. Këto dispozita normative të OAK-së, i referohen mënyrës së ushtrimit të avokatisë, paanshmërisë, korrektësisë, ruajtjes së pavarësisë dhe komunikimit me klient.

Vendimi për masën disiplinore u vendos bazuar në nenin 51 paragrafi 1 pika 1.2 të Ligjit për Avokatinë.


Na ajo që u arsyetua u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

KËSHILLË JURIDIKE


Kundër këtij vendimi, palët kanë të drejtë të paraqesin ankesë në Komisionin e Ankesave të OAK-së, në afat prej 8 ditësh nga dita e pranimit të vendimit. Ankesa i dërgohet Komisionit të Ankesave në OAK, përmes këtij Komisioni.

Komisioni Disiplinor i Odës së Avokatëve të Kosovës
V.KD.Nr.1205-4-1/2021 të dt: 07.02.2023

Procesmbajtësja:
Ma.sc.Vjollca Ajeti



Kryetare e Kolegjit Disiplinor:
Av. Sarandë Beqiri



Zyra Disiplinore e Odës së Avokatëve të Kosovës
Rr. Bekim Fehmiu p.n, Kati IV, 10000 Prishtinë, Kosovë
Tel: 038 610 101